

VENDIM
Nr. 866, datë 11.11.2020

**PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS OVALE
“B” DHE TË ZYRAVE ME NUMRA 2/1, 3, 3/1, 6, 7 E 11, NË AMBIENTET E
PALLATIT TË KONGRESEVE, KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për dhënie me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës ovale “B” dhe të zyrave me numra 2/1, 3, 3/1, 6, 7 e 11, të ndodhura në ambientet e Pallatit të Kongreseve, Komisionit të Prokurimit Publik, për ushtrimin e veprimtarisë së tij.

2. Tarifa e qirasë së sallës ovale “B” dhe e zyrave me numra 2/1, 3, 3/1, 6, 7 e 11 të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve operative (furnizim me energji elektrike dhe ujë) gjatë gjithë periudhës së dhënies me qira.

3. Ngarkohen Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe